



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.449/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj-Rugova kryesues, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

- I. Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, A.nr.449/2025 e datës 07.02.2025.
- II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 1.500.00 (njëmijë e pesëqind) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë 07 Shkurt 2025, kandidatja për deputete nga lista e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Fatmire Kollçaku, ka publikuar, një video në rrjetin social Facebook, të realizuar në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në kundërshtim me dispozitat ligjore zgjedhore, duke shfrytëzuar kështu burimet dhe institucionet publike shtetërore për qëllime elektorale. Më tej në ankesë pretendohet se Kandidatja për deputete, Fatmire Kollçaku, me qëllim të promovimit të numrit të kandidaturës si dhe subjektin politik LVV, shfrytëzon hapësira të institucioneve publike, ku me këtë veprim janë shkelur dispozitat ligjore të nenit 36 paragrafi i LZP-së.

Si provë ankesës ia ka bashkangjitur: CD me përmbajtje të videos në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 09.02.2025, theksohet, pretendimi se Subjekti Politik LVV dhe kandidatja, Fatmire Kollçaku, ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 është pikërisht rasti A.nr. 243/2025 ku është dënuar njëherë për këtë sjellje subjekti përgjegjës andaj konsiderojnë se PZAP-i, ka vlerësuar drejt vendimin për anëtarin në fjalë mirëpo te njëjtës nuk i ka dhënë detyrim që te beje evitimin e shkeljes ne te ardhmen (ex nunc) andaj këtë çështje e bën të gjykuar dhe ankesën e pas afatshme. Më tutje në përgjigje në ankesë theksojnë se edhe pse arsyetimi se shkelja vazhdon të prodhoj efekt dhe se nuk mund të jetë bazë për një dënim të përsëritur dhe e njëjta do të cenonte sigurinë juridike si dhe do te zbehte rolin e procedurës për të cilën është nxjerr njëherë vendim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën, përgjigjen në ankesë, dhe gjeti se

-Ankesa është bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i videos është aktiv në llogarinë e rrjetit social në facebook të kandidates për deputete nga radhët e subjektit politik LDK, Fatmire Kollçaku , mirëpo paneli ka vërtetuar nga provat e ofruara nga pala ankuese se tubimi-video dhe foto është bërë në hapësirat e brendshme në ambientet e Kuvendit, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidates për deputete nga radhët e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), është shkelur Rregullorja Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që kandidatja në fjalë, me qëllim të promovimit të numrit në listën me të cilën kandidon për deputete, ka bërë video, dhe foto në hapësirat e brendshme të Muzeut të Komunës së Istogut, për fushatë zgjedhore, veprim ky i cili bie në kundërshtim edhe me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund te përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit te votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni te administratës publike qoftë te nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje ne zotërim ose te kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose te futen ne mbështetje te ndonjë subjekti politik në zgjedhje”*. E në paragrafin 3 të kësaj dispozite përcaktohet se *“me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik”*.

Sipas përgjigjes së dhënë në ankesë theksohet se kandidatja për deputete, Fatmire Kollçaku, për të njëjtën është dënuar A.nr 243/25 dhe nuk i ka jep detyrim për evitimin e shkeljes në të ardhmen, çka këtë çështje e bënë të gjykuar dhe ankesën të pas afatshme, nuk ndikon në vendimin e PZAP-it për të vendosur ndryshe, sepse e njëjta përkundër gjobës së shqiptuar ka vazhduar duke përsëritur shkeljen e ndaluar nenit 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ashtu që video në fjalë vazhdon të jetë aktive në rrjetin e saj social në Facebook.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, kjo konsiston në atë se subjekti politik

LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet për afërsisht të ngjashme.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.449/2025, datë 10.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform neni 118 paragrafi 4 të LZP-së.